



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.10.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”. (*Komision për dhënie mednimi*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Robert Bitri, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Halit Valteri, Nimet Musaj, Fadil Nasufi, Ilir Pendavinji dhe Zef Shtjefni.

Mungojnë:

Lefter Koka, Eglantina Gjermani, Kujtim Gjuzi

Të ftuar:

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Saimir Muçmataj – Përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Arvid Uruçi - Përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëmëngjesi!

Ju kërkoj ndjesë për vonesën.

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Sot kemi shqyrtimin e projektligjit “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, i cili ka pak kohë që ka ardhur për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi, ndërkohë që komision përgjegjës është Komisioni i Financave dhe Ekonomisë.

Ne këtu kemi variantin e parë të projektligjit të administruar prej disa javësh, të cilit i janë shtuar edhe opinionet e institucioneve partnere. Sot për diskutim kemi variantin final, ku janë inkorporuar vërejtjet dhe sugjerimet e Komisionit Europian. Për më tepër, lidhur me këtë projektligj do të na flasë relatori, zoti Ilir Beqaj, të cilin do ta ftoja të na bënte një prezantim të projektligjit, si dhe plotësimet dhe rekomandimet e Komisionit Europian.

Të ftuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kemi zëvendësministrin, zotin Elton Haxhi; zotin Saimir Muçmataj dhe zotin Arvid Uruçi, të cilët do të bëjnë një prezantim të projektligjit, si dhe do t’u përgjigjen pyetjeve të anëtarëve të komisionit.

Fjala për zotin Beqaj

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Ky projektligj nuk është i panjohur për komisionin tonë, pasi ne kemi bërë më parë edhe një diskutim paraprak. Thelbi i këtij projektligji është krijimi i një instrumenti, i cili synon të nxisë zhvillimin ekonomik të vendit. Një instrument i tillë nuk ekziston për momentin as në formë të drejtpërdrejtë dhe as në formë të ndërmjetme në të gjithë ekosistemin e institucioneve të vendit, të cilat kanë si synim, si objekt apo si mision zhvillimin ekonomik të vendit. Bëhet fjalë për mundësinë e zhvillimit të projekteve të mëdha, të cilat, nga njëra anë, kanë nevojë për kapitale të mëdha dhe, nga ana tjetër, për t’u vënë në zbatim lidhen me marrjen në përdorim të aseteve të ndryshme shtetërore. Eksperienca ka treguar se edhe në rastet kur ka pasur interes ndaj investitorëve të ndryshëm me disponibilitet financiar, hallkat e ngadalta dhe larmia e zinxhirit administrativ ka sjellë mospjekjen e projekteve të tilla.

Korporata këtë synon të bëjë: të marrë përsipër dhe të kthehet në një lloj fondi investimesh për ato raste ku shteti është i interesuar të nxisë drejtpërdrejt zhvillimin. Sigurisht, sot në botë fondet e investimeve janë nga më të larmishmet. Ata vijnë dhe investojnë në fushat e tyre, aty ku kanë interes, por në ato raste, ku vetë shteti dëshiron të

nxisë zhvillimin, deri më sot na kanë rezultuar jo të suksesshme. Ky nuk është një model, që po shpiket në Shqipëri, por është një model që funksionon edhe në vendet e tjera më të zhvilluara. Ideja është ngjizur dhe është maturuar në bashkëpunim me një qendër të specializuar, që ndodhet brenda universitetit të famshëm të Harvardit.

Ndërkohë, vijmë te pjesa më konkrete, e cila ka pasur diskutime jo të vogla në versionin paraprak. Përgjithësisht dy kanë qenë momentet kryesore: krijimi i një mjedisi real gare, sipas rregullave ekzistuese të garave publike në Shqipëri; si dhe cili do të jetë enti i pavarur që do të bëjë kontrollin e aktivitetit financiar dhe administrativ të Korporatës. Pas ndjeshmërive të para ka pasur një komunikim intensiv edhe me Komisionin European, në mënyrë që gjithçka që propozohej, jo vetëm duhej të ishte më pranë standardeve, më pranë qeverisjes së mirë, më pranë qeverisjes së hapur dhe transparente, por edhe më pranë detyrimeve që i burojnë vendit tonë nga Marrëveshja e Stabilizim -Asociimit. Kështu që, me ndihmën e shërbimeve të Kuvendit, ky dokument u është shpërndarë të gjithë kolegëve, ku pasqyrohen edhe propozimet e ministrisë, si dhe ka një përpjekje për të adaptuar edhe këto dy probleme. Madje, ka edhe një dokument që tregon se çfarë përmban versionin fillestar, që propozohet të kalojë për diskutim dhe më pas për votim nen për nen.

Mendoj se në vija të përgjithshme këto janë gjërat më të rëndësishme. I ftoj kolegët ta mbështesin me votë pro nismën në parim dhe më pas jemi të hapur për diskutimin nen për nen.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Beqaj!

Fjala është për zëvendësministrin, zotin Haxhi, për të bërë një prezantim më në detaje të projektligjit!

Elton Haxhi – Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” synon hapjen e një korporate në formën e një shoqërie anonime, ku aksionar i vetëm do të jetë shteti shqiptar, e cila do të përfaqësohet nga ministri përgjegjës për Ekonominë.

Projektligji synon rregullimin, administrimin dhe drejtimin e Korporatës, të objektit dhe të funksioneve të saj, si dhe disa çështje të tjera, të cilat kanë të bëjnë me përdorimin e fondeve, kontrollin e këtyre fondeve të shpenzuara nga Korporata, por edhe me mekanizma të tjerë rregullues, si: komitete mbikëqyrëse apo me komitetin këshillimor, i cili është një instrument shtesë përtej atyre specifikimeve që kërkon ligji për shoqëritë tregtare. Ne jemi

kujdesur që në këtë projektligj të kemi një mbikëqyrje të veprimtarisë së kësaj korporate, por, nga ana tjetër, të sigurojmë edhe pavarësinë e vendimmarrjes së korporatës ndaj organizmave shtetërorë. Kjo sigurohet nëpërmjet përbërjes së këshillit mbikëqyrës, i cili, në shumicën e tij, është i pavarur nga qeveria. Gjithashtu, është edhe bordi këshillimor, i cili në përbërjen e tij ka përsëri shumicë të pavarur. Për më tepër, është parashikuar që një pjesë e pjesëmarrësve në këtë këshill të jenë edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare të zhvillimit. Kjo do të bëjë që ekspertiza dhe pavarësia e tyre në marrjen e vendimeve për vlerësimin e projekteve, në të cilat do të angazhohet Korporata, të jetë një vlerë e shtuar.

Përtej atyre që theksoi deputeti në relacion lidhur me këtë projektligj, unë dua të shtoj se cilët janë mekanizmat që përdoren për momentin për pronën shtetërore. Në historikun e deritanishëm prona shtetërore ose është shitur, ose është dhënë me qira, ose është dhënë me 1 euro për ata investitorë, të cilët kanë përfituar nga kjo skemë. Kjo korporatë do të bëjë të mundur që prona shtetërore të ketë një përdorim edhe më efektiv dhe rentabël për sa u përket përfitimeve që merr shteti nga përdorimi i kësaj prone.

Korporata si kapital fillestar, përveç kontributit monetar që është parashikuar në këtë projektligj nga buxheti i shtetit me një vlerë afërsisht 3 milionë euro, do të ketë edhe një sasi të kufizuar pronash shtetërore, të cilat më tej do të zhvillohen nëpërmjet projekteve dhe studimeve të fizibilitetit. Pra, do të jenë pikërisht këto investimet e para që do të bëjë Korporata në aktivitetin e saj. Siç u tha edhe më parë, kompleksiteti dhe natyra e këtyre pronave është e tillë, që kërkon menaxhimin dhe përdorimin e këtyre pronave nga një korporatë e tillë e cila do të ketë të gjitha kapacitetet e nevojshme për një vlerësim objektiv edhe në aspektin e përfitueshmërisë.

Unë mendoj se është një instrument që ne nuk e kemi dhe na duhet për të realizuar projekte të tilla komplekse, të cilat deri tani kanë rezultuar të pasuksesshme. Për pyetje lidhur me detajet, ne jemi të hapur dhe do t'i diskutojmë.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Po, zoti Baraj, keni fjalën për pyetje.

Më pas e ka fjalën zoti Çaçani.

Besnik Baraj – Unë do të doja të dija: a ka eksperiencë të ngjashme të vendeve me status zhvillimi pak shumë si ne, që i kanë përdorur? A kanë pasur sukses, apo jo?

Pyetja e dytë: a keni bërë konsulta me grupet e interesit në lidhje me këtë çështje?

Faleminderit!

Arlind Çaçani – Faleminderit!

Unë dua t'ju pyes: a keni ju një listë paraprake të pronave që do t'i kalojnë si kapital Korporatës?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Fjalën e ka, zoti Marto.

Më pas zoti Beqaj.

Andrea Marto – Faleminderit, zoti kryetar!

A ka ndonjë vlerësim për buxhetin fillestar që i nevojitet Korporatës të nisë aktivitetin e saj?

Niko Peleshi – Po, zoti Shtjefni.

Zef Shtjefni – Kush e ka kryer deri më sot rolin e kësaj korporate, që ngrihet për herë të parë? Këtu thuhet se Korporata do të ndërhyjë edhe në investime të tjera si brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Unë do të doja një shpjegim për këtë gjë.

Niko Peleshi – Ju lutem, mbajini shënim pyetjet dhe përgjigjuni më pas.

Halil Jakimi – Faleminderit!

Pyetjet e mia janë si më poshtë:

Cilat janë kriteret për përzgjedhjen e pronave, që Korporata do të marrë parasysh si objekt zhvillimi?

Pse nuk ka një paketë të plotë ligjore të qartë me VKM ose me akte të tjera nënligjore, pavarësisht se VKM-të dhe aktet nënligjore dalin pas miratimit të projektligjit, por vjen një projektligj përciptas si ky projektligj investimi? A është Korporata e Investimeve Shqiptare objekt monitorimi i parlamentit? A do të raportojë ajo në parlamentin shqiptar? Ne jemi në dijeni se edhe Kanadaja ka një korporatë investimesh, ashtu siç kanë edhe shtetet e tjera, për shembull, Turqia apo Estonia, të cilat raportojnë. Madje, në Kanada korporata e investimeve raporton çdo vit para parlamentit dhe një herë në 5 vjet bën përsëri një analizë më të thelluar. Parlamenti është institucioni që monitoron Korporatën e Investimeve. Ky projektligj nuk sjell ndonjë lehtësim apo favorizim për të rritur investimet në vend, përkundrazi, lë hapësira për abuzime dhe korrupsion të aferave të qeverisë.

Niko Peleshi – Nëse nuk ka pyetje të tjera, atëherë zëvendësministri të përgjigjet dhe më pas, nëse ka ndonjë pyetje apo koment, mund të vazhdojmë përsëri.

Zoti zëvendësministër, të lutem, të gjitha pyetjet sipas radhës.

Elton Haxhi – Faleminderit!

Lidhur me eksperiencat, zotëria përmendi dy eksperiencë, atë të Kanadasë dhe Turqisë, por unë dua të përmend eksperiencën e një vendi në zhvillim, shumë të suksesshëm, atë të Jordanisë, ku Korporata ka zhvilluar të gjithë zonën e Aqabas. Ne e kemi studiuar

modelin e kësaj korporate dhe rezulton se aty ka pasur një ndryshim rrënjësor në një zonë të pazhvilluar, e cila është kthyer në një motor gjenerues të zhvillimit ekonomik të atij vendi.

Konsultim nuk është bërë, sepse nuk është gjykuar se ka grupe interesi, të cilat janë objekt konsultimi për këtë projektligj, pasi krijohet një sh. a. me pronësi shtetin.

Në lidhje me listën e pronave, këtë pyetje do ta bashkoja me pyetjen për kriteret e vlerësimit të pronave. Ne kemi një dokument, i cili ka bërë analizën e përcaktimit të këtyre kriterëve. Ndërmjet të tjerave, në këto kriterë është gjykuar që të vendoset madhësia e pronës dhe pastërtia e pronës, pra një pronë, e cila nuk ka pretendime nga palë të treta. Gjithashtu, është vendosur si kriter edhe largësia nga rrjeti infrastrukturor, si: lidhja me energji dhe specifikime të tjera për të bërë një vlerësim fillestar të fizibilitetit në përdorimin e kësaj prone. Nuk parashikohet të bëhet një studim i mirëfilltë fizibiliteti, por një *due-diligence* e limituar për sa i përket përshtatshmërisë së pronës për objektin e Korporatës.

Lista e pronave është në studimin fillestar, por ashtu siç e përcakton ky projektligj, kjo listë pronash do të jetë objekt i VKM-së, që është parashikuar të dalë pas miratimit të këtij projektligji, e cila do të përcaktojë pronat që do të kalojnë për kapital në Korporatë.

Kjo lidhet edhe me pyetjen tjetër, pra kjo VKM është e vetmja që parashikon ky projektligj, e cila lidhet me transferimin e pronave, ndërsa në pjesën tjetër të akteve që parashikohet të dalin, të cilat nuk kanë lidhje me VKM-në, përfshihen: miratimi i statutit nga asambleja dhe krijimi i të gjithë strukturës së Korporatës për funksionimin e saj.

Buxheti i parashikuar në projektligj, siç e thashë, është rreth 3 milionë euro, është parashikuar për funksionimin e Korporatës, pra për ngritjen e administratës dhe për studimet që do të kryhen në projektet fillestare. Pra, ky buxhet nuk do të përdoret për investime, por për një funksionim normal të Korporatës për të marrë vendimet e duhura.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky projektligj parashikon që burimet e financimit të jenë nga buxheti i shtetit dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare, të cilët janë aktorët e vetëm që mund të bëhen pjesë e financimit të Korporatës duke injektuar kapital, donacionet apo burime të tjera të ngjashme dhe të ardhurat e veta. Pra, nëse do të fillojë zhvillimi i projekteve e para, atëherë rigjenerimi i të ardhurave do të përdoret për rifinancim apo për shpërndarje dividendi, sipas gjykimit të asamblesë.

Pyetja e fundit ishte për objektin e monitorimit, besoj se të gjitha pyetjet e tjera i adresuam. Sipas projektligjit, AEC-ja është objekt monitorimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, ndërsa organet drejtuese të Korporatës nuk kanë ndonjë detyrim për raportim, ashtu siç nuk

kanë detyrim edhe sh.a-të e tjera shtetërore. Kjo praktikë është zbatuar deri më tani dhe nuk ka ndonjë risi.

Halil Jakimi – Ky model është marrë nga Jordania?

Elton Haxhi – Modeli është studiuar, duke përfshirë edhe modelin jordanëz, por është përgatitur nga CID-ja, që është një institut pranë Universitetit të Harvardit, pra një ekip i tyre ka punuar për hartimin e këtij modeli.

(Ndërhyrja pa mikrofon)

Ky projektligj vjen me disa ndryshime, të cilat reflektojnë të gjitha komentet e bëra nga Bashkimi Europian, Banka Botërore dhe BERZH-i.

Niko Peleshi – Po.

Halil Jakimi – Unë insistoј që Korporata e Investimeve Shqiptare të jetë objekt monitorimi, meqenëse do të menaxhojë asetet kombëtare, pra do të ketë në menaxhim kapitalin e madh ekonomik për zhvillimin e një objektit të caktuar, insistoј të bëhen amendime apo ndryshime që të jetë ashtu siç e ka Kanadaja apo vende të tjera të zhvilluara.

Kam edhe një pyetje: a mendoni se përbën konflikt interesi me pushtetin vendor apo me njësitë e tjera, sepse të miratosh ose të krijosh një strukturë të tillë duhet të ketë akte ligjore dhe një VKM shumë specifike për mënyrën se si do të përzgjidhet prona? Pra, bashkia ka pyjet, kullotat, liqenet, lumenjtë, minierat e të tjera dhe mendoј se mund të përbëjë konflikt interesi në funksionimin e institucionit.

Elton Haxhi – Në lidhje me transferimin e pronave nga pushteti vendor në atë qendror do të zbatohet i gjithë legjislacioni që është në fuqi dhe nuk do të merren vendime për përdorimin e pronave që janë në pronësi të pushtetit vendor nga korporata, pa pasur një vendim të këshillit bashkiak.

Niko Peleshi – Jo, nuk është konflikt, është siguresë.

Po, zoti Konomi.

Ardit Konomi – Faleminderit!

Së pari, përse vetëm një pjesë të aseteve shtetërore kalojnë në administrimin e Korporatës dhe si është mënyra e përzgjedhjes?

E dyta, me sa kuptohet, çdo investim i huaj apo vendas që targeton njërin nga këto asete do të duhet të futet në negociata me Korporatën. Cilat janë parakushtet në një marrëdhënie biznesi? A është subjekt i negociatave të hapura, apo ka disa parakushte?

Elton Haxhi – Në radhë të parë, Korporata nuk është krijuar që të marrë në përdorim të gjithë pronat shtetërore dhe nuk kemi të bëjmë me transferimin e të gjitha pronave shtetërore në kapitalin e Korporatës. Korporata është krijuar vetëm për zhvillimin e një numri

të kufizuar projektesh, të cilat kanë rezultuar të pasuksesshme deri tani. Pra, për prona shtetërore, për të cilat nuk ka pasur ndonjë interes nga investitorët e huaj apo vendas, dhe për prona, të cilat janë dhënë në përdorim, pra ka pasur interes, por kanë dështuar gjatë përdorimit të tyre.

Korporata ka edhe një objekt tjetër të parashikuar në këtë projektligj, që mund të jetë zhvillues i zonave të zhvillimit teknologjik dhe ekonomik, “TEDA”. Një nga projektet, të cilat Korporata mund të angazhohet është që të marrë rolin e zhvilluesit në një prej zonave që janë përcaktuar. Pra, siç e thashë, bëhet fjalë për prona shumë të kufizuara, mund të jenë 2 ose 3, të cilat, në vlerësimin e grupit, që do të angazhohet për vlerësimin e këtyre pronave dhe për renditjen e këtyre pronave, sipas përfitueshmërisë dhe mundësisë për t’i përdorur Korporata, do të gjykohen dhe do të vendosen të kalojnë në kapitalin fillestar të Korporatës. Pra, ekspertët dhe ekipi i saj drejtues do të bëjnë vlerësimin, përgatitjen e planit dhe studimin e fizibilitetit, i cili mund të kërkojë edhe kapital privat. Këtu mund të futet privati. Pra, privati, që do të marrë pjesë në këtë projekt të përbashkët dhe përfitueshmëria e tij në raport me përdorimin e pronave, do të jetë në proporcion me investimin. Prandaj, ne themi që Korporata do të jetë instrumenti i duhur për përdorimin sa më efektiv të këtyre pronave dhe për përfitimin e shtetit, pasi deri tani përdorimi nuk ka qenë efikas. Pra, siç e thashë, ose janë dhënë me 1 euro, ose janë dhënë me qira ose janë shitur. Kjo është një mundësi që ne nuk e kemi shfrytëzuar ndonjëherë.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Besoj se informacioni duhet ndarë edhe me anëtarët e tjerë të komisionit, meqenëse pati pyetje.

Zoti Zëvendësministër, ju e përmendët që kemi pasur një draft të parë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, i cili është pasuruar, korrigjuar dhe sjellë më pranë legjislacionit europian, me vërejtjet e Komisionit Europian, por edhe të institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare. Për shembull, këtu kam letrën e zonjës Mikaela Matuela, e cila është drejtore e Njesisë për Ballkanin Perëndimor në Digji Zgjerimin. Po lexoj vetëm fjalinë e fundit, ku thuhet: “Duam që të konfirmojmë se draftligji i modifikuar për Korporatën Shqiptare të Investimeve, i dërguar te ne më 18 korrik 2019, merr në konsideratë të gjitha komentet tona”.

Për sa i përket, ju e sqaruat por po e rritet, një ndryshim që i është bërë draftit, që lidhet me prokurimin, sipas draftit final, në nenin 10 sqarohet e gjithë procedura e prokurimit për të gjitha rastet, edhe kur kapitali vjen 100% nga një organizatë ndërkombëtare, që, si në çdo kontratë tjetër, zbaton rregullat e prokurimit që parashikohen nga kjo organizatë. Për

shembull, projektet e Bankës Botërore respektojnë rregullat e prokurimit të praktikave të Bankës Botërore.

Në rastin e kontratave me bashkëfinancim, thotë neni 10, kur shumicën e ka një organizatë ndërkombëtare apo institucion financiar ndërkombëtar, palët bien dakord për procedurat e zbatueshme të prokurimit. Kurse për kontratat publike që financohen nga buxheti i shtetit, zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi “Për prokurimin publik”, siç i kemi praktikisht sot. Ky është një ndryshim që është bërë nga varianti i mëparshëm i Këshillit të Ministrave.

Pra, është bërë shumë e qartë e zeza mbi të bardhë, që ky instrument i ri për menaxhimin me logjikë biznesi, komerciale, të pronës shtetërore që hyn në partneritete zhvillimi, nuk tejkalon procedurat e prokurimit publik të pasurisë së aseteve shtetërore publike, përkundrazi, është konform tyre. Ndaj edhe ka marrë miratimin nga Komisioni Europian.

Pas këtij komenti, unë kam një pyetje: Në rastin e ndërtimit të një SPV-je (më falni që nuk di ta them në shqip), për një projekt të caktuar investimi të këtij fondi, si përzgjidhen partnerët privatë që do të shprehin interes për t’u futur atje? Për shembull, korporata vendos të ndërtojë një hidrocentral me para nga buxheti i shtetit, me financime të institucioneve ndërkombëtare, por edhe me financime private. Si përzgjidhen privatët? Me çfarë procedurash? Deri më sot kemi një lloj boshllëku ligjor. Nuk kemi procedurë të konsoliduar për përzgjedhjen e privatëve në ndërtimin e partneriteteve biznesore shtet-privat.

Elton Haxhi – Për sa i përket pyetjes për një SPV, i takon administrimit të korporatës të përgjigjet, për të thënë të drejtën, por po mundohem të gjykoj përtej ligjvënësit.

Në një SPV do të bëhet një studim. Pra, do të jetë një pronë që do të përdoret. Korporata, me burimet e veta, sipas projektligjit, ka për detyrë të bëjë të gjithë studimin se sa janë burimet e financimit që nevojiten, sa do të përballojë korporata me burimet e veta, sa do të japin institucionet financiare ndërkombëtare dhe cila është hapësira që duhet mbuluar nga kapitali privat, përtej këtyre që sapo përmenda.

Normalisht, një vlerësim i tillë do të përcaktojë nevojat për financim, normën e kthimit të investimit dhe në mënyrë proporcionale do të përcaktojë edhe përfitimet që do të marrë secili prej partnerëve që do të futet në këtë SPV. Nëse bëhet fjalë për kapital privat, atëherë besoj se procedurat do të jenë të hapura për konkurrim në lidhje me këtë pjesë të kapitalit privat, e cila nuk do të mbulohet nga fondet e korporatës apo nga fondet e institucioneve financiare ndërkombëtare. Procedurat e konkurimit në lidhje me kapitalin privat do të përcaktohen nga korporata. Në këtë projektligj është përcaktuar që këto

procedura do të jenë sipas standardeve ndërkombëtare më të mira. Besoj që korporata, që në krijimin e saj, do të përgatisë të gjithë mënyrën e funksionimit të saj, e cila duhet t'i përmbahet edhe përcaktimeve të vëna në këtë projektligj në lidhje me përdorimin e fondeve private, fondeve publike apo edhe fondeve të partnerëve ndërkombëtarë.

Niko Peleshi – Pra, i takon korporatës të përcaktojë rregullat se si do t'i përzgjedhë partnerët privatë?

Elton Haxhi - Për sa kohë nuk është përcaktuar në këtë projektligj, padyshim është e drejta e drejtimit të korporatës që nëpërmjet Këshillit Mbikëqyrës të përcaktojë rregulla, të cilat nuk janë të përfshira në këtë projektligj.

Niko Peleshi – Ka pyetje të tjera? Komente? Diskutime?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kalojmë në votimin në parim dhe më pas nen për nen.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? 3 vota kundër?

Miratohet.

Kalojmë në diskutimin dhe votimin nen për nen mbi variantin e përpunuar, me vërejtjet dhe plotësimet e Komisionit Europian.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2, objektivat e korporatës.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3.

Po, zoti Beqaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të diskutoni, por për votimin duhet të presim pak, sepse ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj - Kam një pyetje.

Te germa “I”, thuhet: “respektimi i parimit të konkurrencës së lirë dhe efektive në procedura dhe në treg”. Pastaj thuhet “në përputhje me kuadrin ligjor”. Unë besoj se çdo gjë ne e bëjmë në përputhje me kuadrin ligjor. Mendoj se është e tepërt, sepse edhe nëse nuk e themi, kemi detyrimin të zbatojmë ligjin “Për ndihëm shtetërore”.

Elton Haxhi – Nga Bashkimi European është kërkuar, duke qenë se është një kompani me kapital tërësisht shtetëror, që të theksohet se do të respektohet kuadri ligjor mbi konkurrencën dhe ndihmën shtetërore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne kemi gjykuar që mund ta specifikojmë më saktë këtë çështje, e cila është kërkuar që të jetë në projektligj.

Niko Peleshi – Ju kërkoj të presim pak sa të kthehen kolegët, sepse nuk kemi kuorumin e nevojshëm për të votuar.

(Ndërpritet mbledhja)

Niko Peleshi - Rifillojmë diskutimin nën për nenin 3.

Zoti Beqaj, keni ndonjë propozim konkret për ta hedhur në votim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Hedhim në votim versionin që kemi.

Kush është dakord me nenin 3? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5, funksionet e korporatës.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6, burimet financiare.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7, transferimi i pronave shtetërore.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu II. Masat mbështetëse.

Neni 8, mbështetja me infrastrukturë ndihmëse.

Këtu ka disa pika, prandaj nëse ka ndonjë diskutim, mund t'i hedhim në votim pikë pas pike. Nëse jo, hedhim në votim nenin 8 në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9, marrja e licencave/lejeve.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10. Është nen shumë i rëndësishëm. Siç e diskutuam, ka lidhje me regjimin e prokurimit. Ka dy pika.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu III. Struktura organizative.

Neni 11. Ky nen flet për organet drejtuese të korporatës, si asambleja e përgjithshme, këshilli mbikëqyrës, drejtori ekzekutiv, bordi këshillimor.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12. Ky nen flet për Asamblenë e Përgjithshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Ilir Beqaj – Sa anëtarë do të ketë asambleja e përgjithshme?

Elton Haxhi – Përfaqësuesi i shtetit ... Në kapitalin fillestar 100% janë aksione që i zotëron shteti dhe përfaqësuesi është ministri përgjegjës për Ekonominë. Si i tillë, është vetëm një anëtar. Ka vetëm një aksioner që përfaqësohet nga ministri përgjegjës për Financat dhe Ekonominë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për momentin është vetëm një aksioner.

Po. Është aksioner i vetëm.

Niko Peleshi – Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Në vijim të nenit, thuhet, në momentin e parë statutin do ta miratojë ministri ose një përfaqësues i tij

Kryetar, që Statuti i Korporatës të miratohet vetëm nga një person, kushdoqoftë ai, më duket pak weak.

Niko Peleshi – Si mund të jetë ndryshe, sepse sipas ligjit të shoqërive tregtare është asambleja ajo që bën miratimin e statutit?

Ilir Beqaj - E kuptoj, por atë strategji ta miratojë vetëm ai?

Niko Peleshi – Unë besoj se duhet të jetë me vendim të Këshillit të Ministrave, zoti zëvendësministër, edhe si interpretim ligjor. Ministri përgjegjës për Ekonominë është përfaqësuesi ligjor i pronarit, por jo pronari. Pronari është qeveria. Kështu që, ai shkon në asamble me tagrin e përfaqësuesit ligjor të pronarit dhe duhet të marrë miratimin te pronari.

Pronari është qeveria, kështu që besoj se duhet ta miratojë statutin në qeveri dhe në mbledhjen e asamblesë ai shpreh vullnetin e qeverisë dhe jo atë personal.

Ilir Beqaj – Jemi tek asambleja.

Elton Haxhi – Tek të gjitha sh.a-të ku shteti është pronar, asambleja është ministri përgjegjës për Ekonominë. Në disa raste është ministri përgjegjës për Infrastrukturën. Asambleja është ...

Niko Peleshi – Kush i bën ndryshimet në statut tek “Albpetrol”-i?

Elton Haxhi – Ministri?

Niko Peleshi – Pa e kaluar fare në qeveri?

Elton Haxhi – Po. E parashikon ligji për shoqëritë tregtare, që janë attribute që i ka asambleja dhe jo një organ tjetër.

Niko Peleshi – Por, si mund të zgjidhet, duke pasur parasysh që rregullohet sipas ligjit të shoqërive tregtare?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne mund ta miratojmë këtë ligj me vërejtjet ose sugjerimet tona dhe do t’ia kalojmë komisionit përgjegjës për ta parë. Nëse e gjykojnë të arsyeshme, mund ta rregullojmë më mirë, të modifikohet në seancën ku do të trajtohet. Ne tani nuk jemi në gjendje të bëjmë një propozim konkret.

Do t’u kërkoja shërbimeve të komisionit që ta theksojnë në raport sugjerimin, vërejtjen dhe shqetësimin tonë për këtë nen. Do të ishte mirë që një ndryshim kaq i rëndësishëm në statutin e një korporate të dilte me VKM nëse gjen bazueshmëri ligjore. Ne mund ta formulojmë si vërejtje, por jo si propozim ligjor. Në seancë do të vendoset nëse është e mundur të bëhet pjesë e ligjit.

Kush është dakord me nenin 12? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13 “Këshilli Mbikëqyrës”.

Pika 1 e nenit 13 përcakton se Këshilli Mbikëqyrës ka numër tek anëtarësh, pra jo më pak se 5 anëtarë, ku shumica janë të pavarur. Ky nen është shumë i rëndësishëm, sepse risku që kanë instrumente të tilla është kontrolli politik. Sa më e pavarur të jetë mbikëqyrja përmes Këshillit Mbikëqyrës, aq më i imunizuar do të jetë edhe ky instrument.

Neni 1 e përcakton qartë që Këshilli Mbikëqyrës ka jo më pak se 5 anëtarë dhe shumica duhet të jenë të pavarur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në SPV, po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në projekte.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, në një projekt të caktuar që e financon korporata.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bici po thoshte tjetër gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, më fal që po të përkthej, por kemi të dy të njëjtin shqetësim dhe unë e ngrita si pyetje.

Procedura se si një investitor privat bëhet bashkëfinancues në projekte të veçanta, që i quajmë *special purpose vehicle*, duhet të jetë e mirëpërcaktuar për të garantuar transparencën, sepse risku në instrumente të tilla ngelet klientelizmi. Sa më shumë ta imunizojmë instrumentin nga klientelizmi, nga politika, aq më i shëndetshëm bëhet. Është absolutisht i nevojshëm.

Unë kam qenë pjesë e një grupi që e kemi parë nga afër si funksiononte një organizim i ngjashëm në Jordani. Nuk mund të bëjmë shumë paralelizim, sepse atje është një tjetër sistem. Rajoni, që ishte në dorën e një korporate, të ngjashme me këtë, kishte edhe një lloj autonomie politike, ishte në një nivel më të lartë. Ata kishin një legjislacion të posaçëm, ku edhe nga pikëpamjen legjislative qeveriseshin më vete. Kishte shumë autonomi, por Jordania është monarki, nuk është pjesë e Bashkimit European apo e ëndrrës për t'u bërë pjesë e Bashkimit European. Ne kemi shumë kufizime dhe korniza. Megjithatë, jemi shumë të kënaqur, unë, personalisht, që kemi arritur në një version që ka marrë miratim të plotë formalisht dhe shkresërisht nga Komisioni European. Është përshtatur, është plotësuar, ka ardhur në të gjitha parametrat e legjislacionit european, por gjithmonë ka nevojë për plotësime apo për procedura të akteve nënligjore, që duhen themeluar dhe duhen saktësuar, për ta bërë më transparente dhe më të harmonizuar. Këtë shqetësim kishim ne.

Te Këshilli Mbikëqyrës, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – E para, kam një pyetje.

Këshilli propozohet të jetë me 5 anëtarë. A nuk e ka Kodi i Procedurës Administrative që duhet të jenë gjithmonë 7 anëtarë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, të jetë thjesht numër tek. Nuk ka minimum për numrin e anëtarësisë.

Le kthehemi te shqetësimi që ngritëm. Atëherë, jo vetëm statuti që do të miratohet një nen më lartë, por ky person duhet ta miratojë edhe cili është këshilli. Pra, edhe miratohen rregullat si duhet të sillen, edhe i pyet: kush janë këta?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, sepse ata janë të pavarur. Ata e kanë pavarësinë e tyre, kanë një emër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dikush do të propozojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe kur i votojmë në Kuvend, i marrim për të pavarur, por i votojmë politikisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu është. Ne jemi demokraci parlamentare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe këtë çështje do t'ia sugjerojmë komisionit përgjegjës, që ta shikojë me kujdes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të dyja janë çështje të governancës së korporatës.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – A kemi ndonjë propozim konkret apo...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sugjerime, rekomandime...

Dakord.

Hedhim në votim nenin 13, me të njëjtin rregull, që të shoqërohet më një vërejtje dhe rekomandim për komisionin përkatës, që në seancë, në qoftë se gjejnë hapësirë, ta forcojnë më tepër dhe ta ngrenë në një nivel më të lartë, mundësisht në Këshillin e Ministrave, emërimin dhe lirimin, të paktën emërimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës. Besoj se kjo mund të akomodohet ligjërisht.

Kush është dakord me nenin 13 dhe me këtë vërejtje. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 14, kompetencat e këshillit mbikëqyrës. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15 bën fjalë për drejtorin ekzekutiv, si përfaqësues ligjor i korporatës. Ka 5 pika. Kush është dakord?

Ka një vërejtje zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Te pika 5, shpërblimi, si do ta matim pjesën e performancës në detyrë? Si do t’ia japim bonusin që të performojë mirë? Si e keni...?

Elton Haxhi – Mendoj se këto janë detyrat e këshillit mbikëqyrës, që të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, ka praktika nga më të ndryshmet për matjen e performancës dhe bonusin e performancës. E rëndësishme është të tërheqim njerëzit e duhur, që të performojnë mirë dhe t’u krijojmë mundësinë të angazhohen në këtë korporatë të rëndësishme.

Pastaj për çështjet e rregullimeve, që përcakton ligji i shoqërive tregtare, mendoj se janë kufizime që duhet t’i marrim parasysh edhe në këtë projektligj. Kështu që të gjitha vërejtjet, që kanë lidhje me emërimet apo kompetencat e asamblesë së përgjithshme, duhen parë edhe në këtë këndvështrim, që të mos dalim përtej parashikimeve të ligjit të shoqërive tregtare, duke qenë se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Dakord.

E hedhim në votim nenin 15. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16, kompetencat e drejtorit ekzekutiv. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17 bën fjalë për bordin këshillimor. Bordi këshillimor përbëhet nga 9 anëtarë, që zgjidhen nga asambleja e përgjithshme, pra nga ministri. 3 anëtarë përfaqësojnë institucionet qendrore, 2 anëtarë janë nga institucionet ndërkombëtare financiare të zhvillimit dhe 4 anëtarë janë të pavarur.

Me sa duket, këtu është disi më e përcaktuar dhe më e orientuar zgjedhja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka pasur instrumente të tilla në atë kohë.

A keni ndonjë pyetje apo vërejtje për nenin 17? Ndonjë propozim?

Kush është dakord me nenin 17? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18 bën fjalë për administratën, strukturën, organikën e korporatës, që miratohen nga këshilli mbikëqyrës. Marrëdhëniet e punës së personelit të korporatës rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë dhe akteve të brendshme të korporatës.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu IV, kontabiliteti dhe auditimi i pasqyrave financiare.

Neni 19 bën fjalë për kontabilitetin në llogaritë vejtore. Kush është dakord? Kundër?
Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20, auditimi i pasqyrave financiare. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu V dhe i fundit, dispozitat e fundit.

Neni 21 bën fjalë për aktet nënligjore. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të nenit 7, pika 2 e këtij ligji. Nuk ka afat.

A ka ndonjë vërejtje ose pyetje?

Kush është dakord me nenin 21? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22, dispozitat kalimtare. Ministria përgjegjëse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Beqaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj - ...diskutimeve që bëmë, po ta lexosh nenin 22, thotë se ministria ndjek procedurat e nevojshme për miratimin e statutit. Ministria apo ministri?

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ndjek procedurat e nevojshme për miratimin e statutit, pra ministria ndjek procedurat. Pjesë e procedurës është edhe aprovimi nga ministri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E qartë, pra ndjek procedurat. Në fund, pjesë e procedurës është edhe miratimi nga ministri.

Kush është dakord me nenin 22? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23 dhe i fundit, ka të bëjë me hyrjen në fuqi. Te fjalia “Ky ligj në fuqi”, duhet shtuar folja “hyn”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në zbardhje.

Duhet bërë ky riformulim: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit “Për korporatën e investimeve shqiptare”.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi.

Ju falënderoj!

Falënderoj edhe përfaqësuesit e ministrisë!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA